



PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 10/09/2026
PRIMLJENO:
Nr. No. Br. 01/1578



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E MALISHEVËS

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Me date: 10.09.2026

Duke u bazuar në nenin 78 paragrafi 2, nenin 79 paragrafi 2, nenin 80, 81 dhe 82 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrat e Publik Nr.08/L-197, neni 21 Udhëzimit Administrativ (shëndetësi) numër 04/2020 për Kujdesin Parësor Shëndetësor, si dhe nenin 6 dhe nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore shpallë këtë:

KONKURS

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Titulli i vendit të punës: Drejtor/e i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare

Klasa dhe koeficienti i pagës: H4 - koeficienti 13.5

Kategoria: Nëpunës i Shërbimit Publik

Numri i kërkuar: Një (1)

Orari i punës: 40 orë në javë

Periudha e Kontratës: Me mandat katër (4) vjeçarë

Institucioni: Komuna Malisheve

Drejtoria: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Shpëtim Robaj"-Malisheve

Vendi i Punës: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Shpëtim Robaj"-Malisheve

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

1. Menaxhon punën e përgjithshme të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe cakton objektivat dhe zhvillon planin për përmbushjen e ketyreve objektive;
2. Siguron ligjshmërinë dhe punën profesionale në QKMF, e cila duhet të udhëheqet në pajtim me dispozitat e Statutit të QKMF-së;
3. Në pajtim me politikën shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi të Kosovës dhe strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor, i propozon për miratim DSHMS-së planin e punës dhe buxhetin e QKMF-ë për vitin vijues;
4. Është përgjegjës dhe kujdeset për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF;
5. Kujdeset për zhvillimin dhe avancimin e vazhdueshëm profesional të personelit të QKMF-së;
6. Analizon dhe vlerëson cilësinë e shërbimeve shëndetësore që i ofrohen pacientëve me qëllim të zbatimit të ndryshimeve për rritjen e efikasitetit në punë dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore;

7. Ushtron të drejta, autorizime dhe mban përgjegjësi të tjera në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet tjera normative që kanë të bëjnë me implementimin e Mjekësisë familjare;
8. Koordinon punën dhe bashkëpunon me menaxherët tjerë në institucion;
9. Raporton tek Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë në baza mujore dhe vjetore;
10. Bënë vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara;
11. Kryen edhe punë të tjera zyrtare që i cakton Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë;

Kushtet e përgjithshme për pranim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

Kërkesat e përgjithshme formale:

- Arsimimi i kërkuar: Specialist i Mjekësisë Familjare;
- Licenca e punës (me afat);
- Përvoja e punës e kërkuar: Pesë (5) vite përvojë pune në fushën e shëndetësisë.

Dokumentet e nevojshme:

1. Formulari i aplikimit-i plotësuar;
2. Kopjen e dokumentit personal (letërnjoftimin ose pasaportë);
3. Diploma e Fakultetit të Mjekësisë – Specialist i Mjekësisë familjare (*kopje të noterizuar*); (*Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar*).
4. Kopjen e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. (*Dëshminë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet nga pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale*).
5. Licencën e punës me afat (kopje të noterizuar);
6. Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit;
7. Rezymeja personale (CV);
8. Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit;
9. Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publike (Kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).
10. Dëshmia se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar (**Pas pranimit në punë**);
11. Certifikatën e gjendjes shëndetësore (**Pas pranimit në punë**);



Mënyra e vlerësimit të Kandidatëve/aplikantëve:

- a. Testimi me shkrim (deri në 70 pikë).
- b. Intervista me gojë (deri në 30 pikë).

Mënyra e aplikimit:

Data e shpalljes së konkursit është 10.09.2026, ndërsa konkursi mbetet i hapur 30 ditë kalendarike, aplikacionet dorëzohen nga data **11.09.2026 deri më datën 10.10.2026 (Ora:16:00)**. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në **Administratën e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** gjatë ditëve të punës, e Hënë - Premte nga ora 08:00 deri ora 16:00. Aplikacioni mund të shkarkohet edhe në linkun e mëposhtëm <https://konkursi.rks-gov.net>.

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare;

- Përmes web faqes së Komunës së Malishevës <https://Malisheve.rks-gov.net>, portalit për rekrutim elektronik <https://konkursi.rks-gov.net>, në tabelën e shpalljeve të komunës së Malishevës dhe QKMF-së.

Sqarime shtesë: Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi). Konkurrimi është i hapur për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës si dhe komuniteti jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrarët Publik.

Menaxher i Burimeve Njerëzore



Gani Bahtjaraj

